

ULKU DHE UILLI
VATH KORESHI POSTMODERNIST

Meliza KRASNIQI
Intituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Në këtë punim bëjmë një vështrim të shkurtër të veprës më të mirë të Vath Koreshit, “Ulku dhe Uilli”, njërit ndër romanet e rralla të shkruara me vetëdijen krijuese postmoderne të periudhës postkomuniste.

Romani “Ulku dhe Uilli” është ndërtuar mbi parimet e poetikës postmoderne. Ai nis me paratekst që i vihet narratorit të pabesueshëm. Më saktë, edhe rrëfimi del i pabesueshëm sepse është rrëfim i treguar nga dikush tjetër për dikë tjetër, në retrospektivë. Si rrjedhojë e kësaj, teksti kalon nëpër nivele narracioni të shkallës së tretë.

Koreshi, po ashtu, lë prapa formën klasike të të rrëfyerit dhe provon meta-fiksionin historiografik, një element tjetër esencial i modelit të shkrimit postmodern. Për ta bërë më të hapur këtë qëllim, ai vendos t’i kthehet historisë në mënyrë ironike. E kësaj natyre është edhe gjuha e veprës, një imitim stili i gjuhës arkaike të autorëve të parë shqiptarë, Buzukut, Budit e Bogdanit.

Struktura formale e romanit është e ndarë dhe e organizuar në Libra dhe këta Libra janë të përbërë nga kapituj të shumtë. Në kuptimin narratologjik, seria e ngjarjeve, fabula, e romanit të Koreshit është e përbërë nga tri sekuenca të mëdha. Kjo ndarje lidhet e determinohet nga personazhet, karakterizimi i të cilëve na shpie në kundërvënien e tyre konkrete.

Fjalë çelësa: Koreshi, postmodernizmi, rrëfimi, narratori

Vath Koreshi konsiderohet njëri nga shkrimtarët më të shquar të brezit të dytë të viteve '60 të shekullit XX, pas Dritëro Agollit e Ismail Kadarese. Emri dhe veprimtaria e tij zënë vend të veçantë në letërsisë shqipe në dy periudhat letrare, para dhe pas viteve '90 (në diktaturë dhe në demokraci).

Koreshi u lind më 7 maj 1936 në Lushnjë (Shqipëri) dhe vdiq më 2 shkurt 2006 në Romë (Itali). Studioi letërsinë dhe gjuhën shqipe në Universitetin e Tiranës. Punoi si gazetar, skenarist e publicist, ishte drejtor në Ministrinë e Kulturës, ministër i Kulturës, deputet, drejtoi revistën *Art* dhe ishte drejtor i shtëpisë botuese *Onufri*.

Jetën letrare e filloi me tregime, të cilat i botoi në vitet '60 – '80: *Kur zunë shirat e vjeshtës* (1964), *Toka në hijen e shtëpive* (1968), *Ndërrimi i qiejve* (1972) etj. Për vëllimin më të suksesshëm të tij me tregime, *Dasma e Sakos* (1980), që trajtonte konflikte të brendshme dhe natyra psikologjike të individëve, ambiciet dhe reagimet e tyre, i është dhënë Çmimi i Republikës¹.

Koreshi, duke qenë i dalluar mbi mënyrën se si e strukturonte karakterin e personazhin, vazhdoi të shkruajë skenarë të filmave dhe kësaj pasuroi natyrën e zhanrit. *Rrugë të bardha* (1974), *Gjeneral gramafoni* (1987), *Balada e Kurbinit* (1987) dhe shumë vepra të tjera letrare, Vath Koreshi i ka bërë skenarë filmash, me të cilët ka fituar disa çmime në festivale të ndryshme².

Në vitet '80 ai del me profesion shkrimtar i lirë, për t'iu përkushtuar tërësisht letërsisë dhe deri në fillim të viteve '90 do të botojë dhjetë romane, prej të cilëve më të njohurit janë: *Haxhiu i Frakullës*, *Dasma e Sakos*, *Mali mbi kënetë*, *Balada e Kurbinit*, *Requiem për një grua*, *Ulku dhe Uilli* dhe *Një grua me të verdha në pyllin e Buddhas*.

Krijimtaria e Vath Koreshit, në pikëpamje të poetikave që mëshiron, ajo ndërtohet, fillimisht, mbi parimet e poetikës së realizmit socialist, më vonë të poetikës moderniste e, dikur më vonë, edhe mbi parimet e poetikës postmoderniste. Në leximin interpretativ të prozës së Koreshit është e pashmangshme të mos venerojmë se ato në mënyrë konsistente ndërtohen mbi një bosht përsiatjesh filozofike. Veç kësaj ai ka prirje që këtë filozofi t'ia veshë edhe psikes së personazheve të cilët shpesh kanë raporte të ndërlikuara e dramatike mes vete, por edhe me jetën. Në këto vepra, perso-

¹ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2006, f. 284.

² Lek Gjoka, *Shkrimtari Vath Koreshi*, Gazeta Vatra, 03/02/2021.

nazhet kalojnë peripeci të shumta, vuajnë, vetëgjykohen e gjykojnë, shpresojnë, kërkojnë lumturinë, dashurinë, identitetin e dinjitetin³.

Karakteristikë e veprave të Koreshit është stili dhe gjuha, të cilat i vë në funksion të dallueshëm estetik. Duhet evidentuar se stili i rrëfimit të tij është telegrafik, pra, ngjarjet rrjedhin shumë shpejt e në mënyrë dinamike. Veç kësaj, edhe kapitujt janë të këtij stili: ata janë të shkurtër dhe ditët e vitet kapërcehen edhe vetëm me nga një rresht. Gjithë kjo bën që proza e tij të duket fragmentare, pa çka se fragmentarizmi i tillë nuk e zbeh rrëfimin fare. Narrativa e ngjarjeve del e plotë dhe e përveçme.

Vepra e Koreshit, sidomos ajo e pas viteve të realizmit socialist, është e llojit të veçantë për shkak të gjuhës, situatave dhe ndërtimit kompozicional.

*

Romani *Ulku dhe Uilli*, për herë të parë u botua më 1996 nga *Onufri*, për t'u ribotuar pastaj dy herë: herën e parë, në vitin 2000 nga *Gjon Buzuku* në Prishtinë dhe herën e dytë, në fillim të vitit 2005 nga *Koha Ditore*, si roman i përzgjedhur për ta plotësuar kolanën prej 20 romanesh të shek XX.

Ulku dhe Uilli është vepra më cilësore e Vath Koreshit, e cila, pothuajse bashkë me veprën *Konomea*, konsiderohet si vepra më e organizuar dhe më e veçantë në letërsinë shqipe.

Ky është romani i cili funksionon dhe është modeluar qartas si vetëdije postmoderne, vetëdije kjo që do të na shërbejë si çelës për ta interpretuar.

Romanin e hap Hyrja, një paratekst që pretendon të jetë amëz apo, më mirë të themi, një pseudoamëz, që vihet nën *autorësinë* e Lazër Palit/narratorit. Hyrja gjithashtu mëton të luajë rolin e dëshmisë, sepse jo vetëm që kemi emrin e narratorit, por fitojmë dhe idenë për moshën dhe formimin e tij. Ai i drejtohet lexuesit të mundshëm/narraterit, lexuesit të projektuar, me tekst në kursiv, ku deklaron se rrëfimin që po e rrëfen e ka dëgjuar kohë më parë, rrëfen në retrospektivë, nga njëri i Arpipës së Epërme dhe se është përpjekur ta vë në rend *...Ai ma tregoi këtë histori, që qe ku po mundohem me e vu në rend edhe për ju...* dhe kjo tregon se edhe ai (narratori) ka dorë në rrëfim, të paktën është strukturues a mbarështues i tij.

³ Ymer Çiraku, *Gruaja me të verdha në pyllin e Buddha-s i shkrimtarit Vath Koreshi*, portali www.alb-spirit.com 23/02/2020.

Narratori, duke qenë jashtë historisë që rrëfëhet, pra Pali, nuk merr pjesë në ngjarje, ai vetëm e rrëfen, është narrator heterodiegetik. Rrëfimi i tij nuk është i besueshëm, jo vetëm pse qysh në fillim tregon se *Këtë që kam nisë me shkruar, o ju që ju bekoftë Zoti, ma ka treguar një nga Arpipa e Epërme*, por edhe për shkak se për ta motivuar jo besueshmërinë thotë: *ju lut që t'm'i falni lajthitjet e mendjes seme prej plaku*. Rrëfimi del i pabesueshëm sepse është rrëfim i treguar nga dikush tjetër për dikë tjetër, rrëfim në retrospektivë, i treguar nga një i moshuar që kërkon falje se nuk mund të mbështetet në ndihmën e mbamendjes shkakut i moshës. Rrëfimi i shkruar si dorëshkrim i një prifti për një histori që nuk ka mundur ta shkruajë në rini kalon nëpër nivele narracioni të shkallës së tretë. Narracioni primar paraqet storjen që i rrëfëhet Lazrit nga një i Arpipës së Epërme, narracioni sekondar jep storjen e rrëfyer nga Lazër Pali dhe i treti është storja mbi dy vëllezërit, munshinjur Agushtinin dhe Bdekun. Apo më thjeshtë A-ja (njeri i Arpipës së Epërmes) i rrëfen B-së (Lazër Palit) për C-në (Agushtinin dhe Bdekun).

Në këtë rrafsh themi se ky proces rrëfimi është i natyrës së metafiksionit historiografik, term ky i sajuar nga Linda Hutcheon⁴. Metafiksioni historiografik nuk synon të krijojë besueshmëri, por tenton të rivizitojë të kaluarën (historinë) me një tish të hollë ironie dhe kjo është tipike për postmodernizmin. Vath Koreshi duke iu përmbajtur vetëdijes postmoderne qëllimshëm i kthehet historisë në mënyrë ironike. Fillimisht autori krijon relacion të madh midis kohës kur është shkruar dorëshkrimi, viti 1462, dhe kohës kur daton dokumenti i parë në gjuhën shqipe *Formula e pagëzimit*. Po ashtu, edhe personi historik, Pal Engjëlli, ka mundësi të jetë personazhi fiktiv, Lazër Pali, pasi ata i lidh koha/viti, por edhe vendi dhe të dy ishin pjesë e një *kuvendi* në Mat.

Veç aspektit të trillimit, historisë e ironizmit, kemi edhe elemente të tjera të postmodernizmit, që për një lexuesin model janë të kapshme në secilën instancë leximi. Gjuha arkaike është ajo që bie në sy së pari. Gegërishtja mesjetare, me të cilën nisët shkrimi, nuk është konstante në të gjithë tekstin. Ky imitim i stilit të autorëve shqiptarë të parë (Buzukut, Budit e Bogdanit) është tip intertekstualiteti, më saktë është pastish i pastër. Edhe në aspektin kompozicional, *Ulku dhe Uilli* është shkruar mbi parimin e vetëdijes postmoderne. Organizmi në libra dhe në kapituj, është i konceptuar si një rrëfim biblik. Bile edhe numrat e kapitujve në libra, 12, 14, 17

⁴ Linda Hutcheon, *Poetika e postmodernizmit*, OM, Prishtinë, 2013.

kanë funksione simbolike me prejardhje biblike⁵, e që është formë e dialogimit intertekstual.

*

Për tekstin narrativ, si term e si teori, flitet që nga Shklovski⁶, Propp⁷ e deri te Mieke Bal⁸. Kjo e fundit sugjeron se baza më e mirë për studimin e teksteve narrative është nëse bëjmë dallimin treshtresor - tekst, storje dhe fabulë. Fabula, sipas saj, është seri ngjarjesh të lidhura logjikisht dhe kronologjikisht, që shkaktohen ose përjetojnë nga aktorët. Ndërsa storja është përmbajtja e tekstit dhe prodhon një manifestim, modulim dhe “ngjyrosje” të veçantë të fabulës. Fabula, e kuptuar si material ose përmbajtje e punuar në storje, është definuar si seri ngjarjesh. Kjo seri është e ndërtuar sipas rregullave të caktuara. Këtë e quajmë logjikë e ngjarjeve⁹. Si rrjedhojë, seria e ngjarjeve në romanin *Ulku dhe Uilli*, pavarësisht *Hyrjes* së shkruar nga Lazër Pali, nis *in medias res*. Sepse sistematikisht *Hyrja*, teksti i narratorit, quhet tekst “primar” dhe nuk duhet të ngatërrohet me tekstin e ndërfutur. Kjo do të thotë se lidhja e tyre është vetëm në nivel teknik dhe ato nuk kanë status të barabartë as në natyrë as në intensitet.

Teksti i ndërfutur të *Ulku dhe Uilli* paraqet storjen e plotë të Agushtinit dhe Bdekut, me fabulë të elaboruar dhe në gradualisht harrojmë fabulën e narratives primare, pra *Hyrjen* e shkruar nga Lazër Pali. Në kuptimin narratologjik, seria e ngjarjeve, fabula, e romanit të Koreshit është e përbërë nga tri sekuenca të mëdha.

Në sekuencën e parë paraqiten katër personazhe në një vend, në malet e veriut shqiptar dhe në një kohë, në mesjetën shqiptare në shekullin XV. Munshinjur Agushtini dhe vëllai i tij binjak, munshinjur Bdeku, shërbejnë në dy kisha, atë të Shndoit dhe të Shndreut; Luçia, një prostitutë nga fshati dhe Hura, që shfaqet kalimthi dhe balancon dy personazhet e para. Konflikti i dy vëllezërve, Agushtinit dhe Bdekut, zë fill kur Luçia ngatërron të parin me të dytin, me të cilin kishte një lidhje seksuale. Vëllezërit rrahen, grinden dhe braktisin të dy kishat. Agushtini përfundon në manastirin e

⁵ Milazim Krasniqi, *Romani “Ulku dhe Uilli” i Vath Koreshit*, www.perpjekjashqiptare.com, 25/09/2021.

⁶ Viktor Shklovsky: Extract from *Russian Formalist Criticism: Four Essays* translated and with an introduction by Lee T. Lemon and Marion J. Reis (Lincoln, University of Nebraska Press, 1965).

⁷ Vladimir Propp, *Morfologjia e përrallës*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2011.

⁸ Mieke Bal, *Narratologjia*, Botimet Artini, Prishtinë, 2021, f. 32-33.

⁹ Po aty.

Shëndërtarit pasi e përjeton rëndë shthurjen e vëllait, ndërsa Bdekun shkon në qytetin Urbs e i vihet në shërbim Bojrogut pushtues (turkut). Sekuenca e parë dhe Libri i parë përfundon me vdekjen e Luçies dhe ikjen e vëllezërve nga fshati, në drejtime të kundërta. Kjo sekuencë në aspektin e ideve filozofike do të mund të interpretohej si konflikt midis moralit fetar dhe mëkatit njerëzor dhe e *përligj* titullin *Ulku dhe Uilli*, ku Ujku simbolizon njeriun e pangopur, ndërsa Uilli ndonjë objekt a person të shkëlqyer e madhështor, pra hyjnor.

Katër Librat në vijim *rrudhen* në një sekuencë të vetme, të dytë, që mbizotërohet me personazhe të tjera, me funksion statutar, për sa i përket rëndësisë, pak a shumë të njëjtë. Dy personazhe burra: Frederiku e Vrana, dhe dy gra: Domenika, gruaja e të parit dhe e dashura e të dytit dhe natyrisht personazhi i Hurës si personazh kyç i një pikë lidhjeje drejtpeshimi. Përjashto këtu Librin e katërt, ku Hura shkon ta takojë Bdekun lidhur me djegien e kishave, ngjarje kjo që prishë linearitetin dhe e fragmentarizon strukturën narrative e që i përgjigjet vetëdijes krijuese postmoderne të autorit. Historia e Vranës, personazh pothuajse i çmendur që është krejtësisht i prirë nga instinkti, Domenikës, e cila gjithashtu është e nxitur nga instinkti seksual dhe përfundon e shkatërruar trupërisht e shpirtërisht dhe e Frederikut i cili vdes gjatë djegies së shtëpisë, është sekuencë narrative e paralajmëruar dhe interpretohet si kufi e skaj i imorales. E gjithë kjo ligësi në shpirtin e personazheve merr përmasa të zgjeruara dhe bashkëdyzohet me përshkrimin e vendit e me gjendjen e krijuar që i përngjan skëterrës, ngrysjes e tmerrit. Në këtë lexim shënjohej Ulku/Ujku, e keqja dhe vetmia.

Libri i fundit, sekuenca e tretë, si rreth vicioz, rikthen në rrëfim personazhet e para. Munshinjur Agushtini kthehet nga jeta e eremitit, kthehet edhe munshinjur Bdeku, tani ithtar i Faltores së Bojrogut dhe padyshim Hura. Kjo sekuencë, sikur ato dy parapraket, plotësohet edhe me një *figurë* të katërt, që del të jetë ikona e Shën Mërisë. Në këtë pikë mbyllet struktura e personazheve, dy gra dhe dy burra. Kjo sekuencë zbulon shenjat e ringjalljes, dritës, hyjnore. Agushtinit i shfaqet një zë si vegim *Nuk është djegur, E keni atje*, të shpëtuar dhe të padjegur gjejnë *Ikonën e T'Lumnumes* që simbolizon rilindjen, përtëritjen, qielloren. Zoti krijon në natyrë, në shpellë, një kapele ku ruan ikonën dhe të gjithë mrekullohen. Jetësohen ritet fetare, rikthehet vetëdija e forcohet feja dhe gjithçka nis nga fillimi. Nga gjendja e zisë, Koreshi na shpie kah Drita dhe këtu gjejmë ndërlidhjen mjeshtërore të Ulkut dhe Uillit, realitetin fatal dhe rilindjen shpirtërore.

Bota e romanit nuk ndërtohet vetëm mbi kundërvënien e personazheve: të mirë dhe të këqij, ku Bdeku simbolizon të ligët dhe mëkatarët,

ndërsa Agushtini të devotshmit dhe të moralshmit. Personazhet dualizohen që në fillim të veprës dhe nuk është se Koreshi ka krijuar kategori njerëzish përmes këtyre dy personazheve. Ky do të ishte kuptim literal për një lexues semantik, por romani, për lexuesin semiotik, e ka edhe një shtresë të dytë më të thellë kuptimi. Lexuesi i tillë, veç tjerash, vëren bashkëjetesën e të kundërtave në pothuajse secilin personazh. Ulku dhe Uilli, drita dhe terri, e bardha dhe e zeza, instinkti dhe arsyeja, e forta dhe e liga bashkë-ekzistojnë në çdo qenie njerëzore si nata dhe dita. Antiteza Ujk dhe Yll, si raport i ndërlikuar, ekziston dhe reflektohet njëherazi në secilën epokë të zhvillimit njerëzor. Ujku në tokë dhe ylli në qiell si binom kundërvëniesh nuk shënjon dy botë, por një jetë.

Koreshi ka rrëfyer bukur me një vetëdije krijuese, të theksuar, postmoderne mbi arsyen njerëzore, duke bërë një gjetje jo të zakonshme të gjuhës, stilit, teknikës e të strukturës së veprës. *Ulku dhe Uilli* është tekst që duhet rilexuar për shkak të fuqisë estetike dhe parametrave letrarë mjaft cilësorë.

Literatura

Bal, Mieke, *Narratologjia*, Botimet Artini, Prishtinë, 2021.

Çiraku, Ymer, *Gruaja me të verdha në pyllin e Buddha-s i shkrimtarit Vath Koreshi*, 23/02/2020.

Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqiptare*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2006.

Gjoka, Lek, *Shkrimtari Vath Koreshi*, Gazeta Vatra, 03/02/2021.

Hutcheon, Linda, *Poetika e postmodernizmit*, OM, Prishtinë, 2013.

Koreshi, Vath, *Ulku dhe Uilli*, "Koha Ditore", Prishtinë, 2005.

Krasniqi, Milazim, *Romani "Ulku dhe Uilli" i Vath Koreshit*, 25/09/2021.

Propp, Vladimir, *Morfologjia e përrallës*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2011.

Shklovsky, Viktor: Extract from *Russian Formalist Criticism: Four Essays* translated and with an introduction by Lee T. Lemon and Marion J. Reis (Lincoln, University of Nebraska Press, 1965).

ULKU AND UILLI
VATH KORESHI POSTMODERNIST

Summary

The world of the novel, "Ulku and Uilli" of Vath Koreshi, is not built only on the opposition of the characters: good and bad, where Bdek symbolizes wicked people and the sinners, while Augustine symbolizes the devoted and the moral people. The characters are dualized from the beginning of the book and it is not that Koreshi has created categories of people from those two persons. This would be the literal meaning for a semantic reader, but the novel also has a second layer of the meaning for the semiotic reader. Such a reader, among other things, observes the coexistence of opposites in each character. Ulku and Uilli, light and darkness, white and black, instinct and reason, strong and evil, co-exist in every human being like night and day. The *Wolf* and *Star* antithesis, as a complex relationship, exists and is reflected simultaneously in each era of human development. The Wolf on earth and the Star in the sky, as a binomial oppositions, do not signify two worlds but one life.

Koreshi has beautifully narrated with a creative, pronounced, post-modern consciousness on human reason making an unusual finding of language, style, construction and technique of the book. Ulku and Uilli is the text that needs to be re-read due to its aesthetic power and high qualitative literary parameters.